



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

SENATI

Prilipi no. 4	09.02.2022
Zyra e pranimat	Titulli i protokolli
308	01-16

NJOFTIM

Në mbledhjen e rregullt të Senatit, të mbajtur më datë: 07.02.2022, miratohet kërkesa e Divizionit për Shërbim të Studentëve dhe lejohet hapja e konkursit për transfer nga IAL në RKS në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren.

Shpallja e konkursit është bazuar në udhëzimin administrativ 13/2018 për Sistemin e Menaxhimit Administrativ në Arsimin e Lartë. Sipas këtij udhëzimi, në nenin 7 afatet Ligjore për regjistrim dhe vendosjen e të dhënave në SMAIL:
pika 3: IAL mund ta bëjnë regjistrimin në SMAIL të studentëve të cilët bëjnë transfer nga një program në programin tjetër studimor brenda IAL, apo nga një institucion tjetër në fillim të çdo semestri:
pika:3.2: Nga 23 Shkurti deri më 28 Shkurt për semestrin Veror.

Të gjithë të interesuarit për transfer nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, afati për transferim është i hapur nga 09.02.2022 deri më 18.02.2022.

Aplikimi bëhet përmes SMU-së Linku për aplikim: smu.uni-prizren.com/StudentiKerkesaTrasfer

Kushtet për pranimin e studentëve dhe dokumentacioni i nevojshëm:

1. Të ketë të përfunduar vitin e parë të studimeve;
2. Kërkesa për transferim;
3. Dëshmi për vërtetimin e semestrit së paku 2020/21 apo edhe 2021/2022;
4. Certifikatën e notave dhe ID;
5. Certifikata e lindjes.

Të gjitha dokumentet e nevojshme duhet të jenë në original së bashku me aplikacionin nga sistemi.

Dokumentacioni dorëzohet vetëm në kopje fizike tek Zyrtari për shërbime studentore tek Fakulteti përkatës.

Komisioni i Studimeve i Fakultetit përkatës do t'i shqyrtojë kërkesat dhe do t'i njoh notat nga Fakulteti paraprak jo më vonë se deri më datën 22 Shkurt 2022.

